



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org: Org. Jedin Org. Unit	01
Nr. i faqevs Broj strana No. pages	1
Nr. Prof. Br. Prof. Prof.No:	3318
Dati: Datum: Date:	31.12.21
PRISHTINE/A	
NO.1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Nr. _____
Data: 31.12.2021

Në mbështetje të nenit 25, par.1, nën-paragrafi 4 i Ligjit Nr.05/L-081 për Energjinë, bazuar në nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe neni 5 par.5, dhe neni 7 të Udhëzimit Administrativ (MZHE) Nr.04/2017 mbi Rregullat për Masat Kufizuese të Furnizimit me Energji në Situata Emergjente, përfshirë pikën 5 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/51 i datës 24.12.2021, Ministria e Ekonomisë, në bazë të rekomandimit të Komitetit Teknik Emergjent, në takimin e mbajtur me datën 30.12.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Obligohen të gjitha subjektet, qoftë persona fizikë apo juridikë, të cilët në mënyrë direkte apo indirekte janë të përfshirë në prodhimin e kriptovalutave në territorin e Republikës së Kosovës, që të njëjtat t'i ndërprejnë.
2. Energjia e ofruar nga KESH, sipas marrëveshjes në mes të KESH dhe KEK, të alokohet tek të licencuarit sipas prioriteteve (FSHU, KEDS dhe KOSTT), sipas marrëveshjeve në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

Ministrisë së Punëve të Brendshme;
Policisë;
Inspektoratit të Energjisë;
KEK Sh.A.
Arkivit.

Artane Rizvanolli

Ministre e Ekonomisë